# DËSHMI ARKIVI

**A-435001**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 19 vatra zjarri në vend, 10 ende aktive, Ministria e Mbrojtjes: Nuk ka rrezik për zonat e banuara – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/19-vatra-zjarri-ne-vend-10-ende-aktive-ministria-e-mbrojtjes-nuk-ka-rrezik-per-zonat-e-banuara/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 12:58:17 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 12:54:01 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `facfdc5059df9210401a39c68cea0cfb487d953c6e8554d7313373aacd311038` |
| TEKSTI | `bdf9b3b992431ebdde24f8477b1c1292fb532ae23fe52b478f06ada6a8303c0e` |
| PAMJA | `5c56ecc11800fcc235233c509998286fd9e6fe04cd55e82fd9fe70eef5c3c4a4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `492eb9c6efef96e4eac70adfe20b8231a26833c2d418e202de56d2e0bc4706d7` |
| E MËPARSHMJA | `9eeacd42b47c23afa9eceff4f14e439964192e2b8094956e6074758cf3e3970b` |
| RRËNJA MERKLE | `7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/492eb9c6efef96e4eac70adfe20b8231a26833c2d418e202de56d2e0bc4706d7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

dhënat janë bërë publike nga Ministria e Mbrojtjes në përditësimin e situatës në orën 14:00.

Në operacionet për shuarjen dhe kontrollin e flakëve janë angazhuar 316 forca operacionale vendore dhe lokale, si dhe 7 automjete zjarrfikëse. Forcat e Armatosura kanë vendosur në dispozicion 130 efektivë, 2 automjete zjarrfikëse, 13 mjete, një autoambulancë dhe një dron.

Në Qarkun e Tiranës, vatra në Malin e Dajtit vijon të jetë aktive. Në terren ndodhen 25 zjarrfikës dhe 7 forca të ADZM-së, të mbështetur nga 52 efektivë të Forcave të Armatosura, 6 mjete dhe një autoambulancë. Sipas autoriteteve, nuk ka rrezik për zonat e banuara. Vatrat në Malin e Bërzhitës dhe Malin me Gropa janë izoluar dhe vijojnë të mbahen nën mbikëqyrje.

Në Qarkun e Dibrës, aktive mbeten vatrat në Lundre–Madhesh, Cerrujë–Mali i Allushit, Selishtë dhe Pleshë. Ndërkohë, Qafa e Helmes mbahet nën mbikëqyrje. Forcat vendore, zjarrfikëse, pyjore dhe vullnetare vijojnë ndërhyrjen në terren, ndërsa nuk raportohet rrezik për zonat e banuara.

Në Qarkun e Lezhës, vatra në aksin Kalivaç–Zimaj–Rras i Butë–Ungrej vijon aktive. Në operacion janë angazhuar forcat vendore, 41 efektivë të Forcave të Armatosura, një automjet zjarrfikës dhe 4 mjete ushtarake. Aktualisht nuk ka rrezik për banesat. Vatra në Gallatë të Kurbinit është nën mbikëqyrje.

Në Elbasan, vatrat në Qukës dhe Gurëshpatë mbahen nën mbikëqyrje.

Në Qarkun e Shkodrës, aktive vijojnë vatrat në Porav, Mnelë e Madhe dhe

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

Rragam, ndërsa Tërbuni është nën mbikëqyrje. Në Rragam vijon puna e strukturave të MZSH-së, Shërbimit Pyjor, forcave bashkiake dhe Emergjencave Civile. Edhe në këtë zonë nuk raportohet rrezik për banesat.

Në Qarkun e Fierit, Peshtani mbahet nën mbikëqyrje, ndërsa vatra në Çërrilë të Mallakastrës vijon aktive. Përveç strukturave vendore, në terren janë angazhuar edhe 32 efektivë dhe 3 mjete të Forcave të Armatosura.

Në Qarkun e Korçës, vatra pranë Oparit është nën mbikëqyrje dhe nuk paraqet rrezik për banesat.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile vijon monitorimin e pandërprerë të situatës në të gjithë territorin, në koordinim me prefekturat, bashkitë dhe strukturat e sistemit të Mbrojtjes Civile.

Autoritetet bëjnë me dije se kapacitetet operacionale mbeten në terren dhe në gatishmëri për ndërhyrje, me prioritet mbrojtjen e jetës, banesave dhe pasurisë së qytetarëve.

#MinistriaEMbrojtjes #Zjarre

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI

**"Smart City", Kumbaro: Kamerat...**

Xhuljana Zhuleku · 19 minuta më parë



VENDI

**Nis shkolla, Kumbaro prezanton risitë në...**

Xhuljana Zhuleku · 31 minuta më parë



VENDI

**Nis sezoni i ri shkollor, 680 nxënës më pak...**

Xhuljana Zhuleku · 2 orë më parë



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.